

AUDITIMI MBI VERIFIKIMIN E ZBATIMIT TË MASAVE TË REKOMANDUARA NË AUDITIMET E USHTRUARA GJATË VITIT 2014, NË SUBJEKTET E ADMINISTRATËS DOGANORE DHE TATIMORE

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në subjektet e administratës doganore DP e Doganave dhe Degët Doganore Berat, Bllatë, Qaf Botë, Kakavijë, Vlorë, Fier, Durrës, Morinë, Rinas, Tiranë, Kapshticë si dhe në subjektet e administratës tatimore DPTTV Bashkia Tiranë, DTTV Bashkia Fier, DTTV Bashkia Shkodër, DTTV Bashkia Elbasan, DTTV Bashkia Korçë me objekt “Mbi verifikimin e zbatimit të masave të rekomanduara në auditimet e ushtruara gjatë vitit 2014” dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me Vendim të Kryetarit të KLSH-së nr. 6, datë 30.01.2015 dhe nr. 13, datë 20.02.2015.

Bazuar në nenet 15, 25 dhe 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, me shkresat nr. 1130/32, datë 25.02.2015; 1130/33, datë 25.02.2015; 1130/34, datë 25.02.2015; 1130/35, datë 25.02.2015; 1130/36, datë 25.02.2015; 1130/37, datë 25.02.2015; 1130/38, datë 25.02.2015 dhe 1130/45, datë 21.05.2015, janë rekomanduar dhe rikërkuar zbatimi i masave të pazbatuara, në subjektet Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe Degët Doganore Tiranë, Durrës, Kapshticë, Kakavijë, Fier, Bllatë dhe Vlorë.

Kontrolli i Lartë i Shtetit ka rikërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

Nga **Drejtoria e Përgjithshme e Doganave**, rikërkohet zbatimi i rekomandimeve të KLSH të dërguar me shkresën nr. 433/12, datë 12.09.2014, të cilat nga auditimi i kryer kanë rezultuar të pa zbatuara, sa më poshtë:

Rekomandimi A3 Drejtoria e Përgjithshme e Doganave të marrë masa që, në zbatim të Manualit për MFK, pika 4.2.9 “Grupi për menaxhimin strategjik”, ku thuhet: “Vendimet e Grupit duhet të merren në mënyrë kolegjiale dhe objektive duke patur në vëmendje interesin publik dhe në përputhje me standardet etike të sektorit publik, Vendimet e Grupit duhet të pasqyrohen në dokumente dhe t’i vihen në dispozicion menaxhimit të njësisë”, të dokumentojë vendimet e Grupit të Menaxhimit Strategjik.

Rekomandimi A5 Drejtoria e Përgjithshme e Doganave të marrë masa që të hartohet harta e proceseve të punës, si dhe gjurma e auditimit, ku të përshkruhen dhe dokumentohen me hollësi: procesi, nën proceset, objektivi i procesit, struktura përgjegjëse, përshkrimi i procesit, njësitë dhe strukturat që përfshihen në proces, kuadri ligjor dhe afati kohor (sipas shtojcës 3 dhe 4 të Manualit, për MFK).

Rekomandimi A7 Nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave në bashkëpunim me Ministrinë e Financave të hartohet udhëzim mbi mënyrën e pagesave të shpenzimeve për udhëtim e dieta brenda vendit, për punonjësit e Departamentit Operativo-Hetimor të DPD-së (Antikontrabanda), si rast specifik, për arsye të natyrës së punës së këtij departamenti, në zbatim të VKM nr. 997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit” konkretisht të pikës 1 ku thuhet: “Punonjësit e njësisë të qeverisjes së përgjithshme, të cilët gjatë ditëve zyrtare të punës shkojnë me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit, trajtohen financiarisht për përballimin e shpenzimeve të shërbimit”.

Nga **Dega e Doganës Durrës**, rikërkohet zbatimi i rekomandimeve të KLSH të dërguar me shkresën nr. 12/10, datë 30.06.2014, të cilat nga auditimi i kryer kanë rezultuar të pa zbatuara, sa më poshtë:

Rekomandim A2 Dega e Doganës Durrës, autoriteti doganor kompetent, të marrë masa për zbatimin e rekomandimeve nr. 2 dhe nr. 4-10, për shpërbllim dëmi në vlerën 36,437,104 lekë rekomanduar për zbatim nga KLSH në auditimin e mëparshëm.

Nga **Dega e Doganës Tiranë**, rikërkohet zbatimi i rekomandimeve të KLSH, të dërguar me shkresën nr. 11/16, datë 30.06.2014 të cilat nga auditimi i kryer kanë rezultuar të pa zbatuara, sa më poshtë:

Rekomandimi A1 Dega e Doganës, Tiranë në bashkëpunim me DP të Doganave, duke ndjekur rrugët ligjore të marrë masa për miratimin e zonës doganore ku ushtron aktualisht aktivitetin, sipas kërkesave të ligjit nr. 8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Rekomandimi A3 Nga Dega e Doganës, Tiranë të merren masa që të bëhen efektive marrëveshjet e lidhura me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe Zyrën e Regjistrimit të Pasurive si dhe të rritet bashkëpunimi me bankat e nivelit të dytë, QKR dhe Zyrat Përmbartimore me qëllim që të zbatohen plotësisht urdhrat e ekzekutimit për vjeljen me forcë të borxhit doganor.

Rekomandimi A5 Dega e Doganës, Tiranë, në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike pranë DP të Doganave të marrë masa për fillimin e negociatave me subjektet dhe ndjekjen në rrugë gjyqësore duke bashkëpunuar me Avokaturën e Shtetit për kthimin në buxhetin e shtetit të shumës prej 42,000,399 lekë nga subjektet që janë rimbursuar në kundërshtim me kriteret e ligjit nr. 61/2002 “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, neni 43, pika 5 e VKM nr. 128, datë 20.02.2013 dhe Udhëzimi nr. 3, datë 19.04.2013 i ndryshuar, i Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave, e kërkuar me shkresën nr. 20221/1, datë 19.11.2013.

Rekomandimi A9 Dega e Doganës, Tiranë të marrë masa për plotësimin e dosjeve të subjekteve që operojnë në regjimin e magazinës fiskale me kalibrimet dhe certifikimet e pajisjeve që përdoren nga subjektet në zhvillimin e aktivitetit të tyre si dhe të rritet shkalla e monitorimit të veprimtarisë së subjekteve në terren në lidhje me dokumentimin dhe evidentimin e mallrave të akcizës sipas tarifave, kodit të mallrave dhe kontrollit direkt në magazinat fiskale.

Rekomandimi A10 Nga Dega e Doganës, Tiranë, të hartohet një program pune për implementimin e ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” sidomos në përcaktimin e objektivave sipas prioritetëve, plan veprime konkrete për realizimin e objektivave, bashkërendimin e veprimtarive që lidhen me identifikimin dhe vlerësimin e rrisqeve, që vënë në rrezik arritjen e objektivave të institucionit dhe ngritjen e sistemit për menaxhimin e riskut, në përpjesëtim me përmasat e tij, këshillimin dhe dhënien e instruksioneve punonjësve të institucionit për menaxhimin financiar dhe kontrollin si dhe rregullimin e veprimtarisë së Degës Doganore nëpërmjet hartimit dhe miratimit të një rregullore të brendshme për kushtet specifike të degës si një nga dy degët që përballon volumin më të madh të përpunimit të informacionit dhe peshës që zë në të ardhurat nga sistemi doganor, në përputhje me përcaktimet e Rregullores së Brendshme të doganave nr. 19095/2, datë 12.11.2012.

Rekomandimi A12 Nga Dega e Doganës, Tiranë, të ndërpritet shpërndarja e pakontrolluar e karburantit në formën e tollonave pa justifikuar shpenzimet e transportit dhe të merren masa që, në bashkëpunim me DP të Doganave, të bëhet e mundur sigurimi i mjeteve të transportit për transportimin e personelit doganor nga dega doganore me vendndodhje në Vorë në drejtim të

Tiranës dhe anasjelltas në kuadrin e ushtrimit të përgjegjësive institucionale si rakordime me institucione, kontrole etj.

Rekomandimi A13 Nga Dega e Doganës, Tiranë, të merren masa që Kontrolli Aposteriori dhe doganierët që kanë ndjekur regjimet e përpunimit aktiv, për diferencat e trajtuara në raport të rezultuara vetëm nga krahasimi i deklarimeve të subjektit me dokumentet e mbylljes së regjimit, të saktësojnë këto diferenca në ambientet e subjektit, nëpërmjet ballafaqimit me dokumentacionin kontabël të subjektit, duke analizuar shkaqet e nxjerrë përgjegjësinë dhe, mbi përfundimin, të llogariten detyrimet me destinacion të ri doganor.

Nga **Dega e Doganës Kapshticë**, rikërkohet zbatimi i rekomandimeve të KLSH dërguar me shkresën nr. 322/8, datë 30.06.2014, të cilat nga auditimi i kryer kanë rezultuar të pa zbatuara, sa më poshtë:

Rekomandimi A3 Dega e Doganës Kapshticë, të nxjerrë urdhër të brendshëm në mënyrë që doganierët e klasifikim-vlerësimit doganor, të lënë gjurmë mbi mënyrat e vlerësimit të mallrave, në zbatim të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 4, pika 19, si dhe të udhëzimit nr. 25, datë 30.11.2007, pika 6.

Rekomandimi A4 Dega e Doganës Kapshticë, të marrë masa që kontratat që lidhin operatorët ekonomikë vendas me eksportuesit e mallrave, të përmbushin të gjitha elementët ligjorë, për t’u pranuar si të tilla, mbasi është vepruar në kundërshtim me VKM nr. 134, datë 07.03.2003 “Për vërtetimin dhe legalizimin e dokumenteve të lëshuara në Republikën e Shqipërisë, për përdorim jashtë vendit dhe të dokumenteve të huaja, për përdorim brenda vendit”.

Rekomandimi A11 Dega e Doganës Kapshticë, të marrë masa që në asnjë rast të mos mungojë bashkëlidhur praktikave doganore prokura e përgjithshme, akti i përfaqësimit të drejtpërdrejtë, apo të tërthortë të subjektit nga agjencia doganore e cila duhet të jetë e regjistruar dhe e shoqëruar me kartën e identitetit të agjentit doganor, të gjitha këto në zbatim të kërkesave të neneve 17, 26 të Kodit Doganor, VKM nr. 205, datë 13.03.1999 “Për dispozitat zbatuese të KD” të ndryshuar, si dhe pikat 35, 36, 37/2, të udhëzimit nr. 9, datë 19.12.1999 dhe neneve 70,76 të Kodit Civil.

B. MASA SHPËRBLIM DËMI

Nga **Dega e Doganës Durrës**, rikërkohet zbatimi i rekomandimeve të KLSH, të dërguar me shkresën nr. 12/10, datë 30.06.2014, të cilat nga auditimi i kryer kanë rezultuar të pa zbatuara, sa më poshtë:

Rekomandimi B2 Të arkëtohet vlera prej 252,006,025 lekë, nga subjektet, sipas trajtimit në faqet 32-130 të RPA, për mos llogaritje dhe mos arkëtim të detyrimeve doganore dhe penalteteve sipas KD, për pranim të vlerës së transaksionit jo në përputhje me kërkesat dhe kriteret ligjore, paraqitur në anekset nr. 1-1-1/10, të pa përfshira në vendimet e nxjerra nga Dega Doganore.

Rekomandimi B3 Të arkëtohet vlera prej 21,342,988 lekë, nga subjektet, sipas trajtimit në faqet 130-198 të RPA, për mos llogaritje dhe mos arkëtim të detyrimeve doganore dhe penalteteve sipas KD, për pranim të vlerës së transaksionit jo në përputhje me kërkesat dhe kriteret ligjore, paraqitur në anekset nr. 2-2/5, të pa përfshira në vendimet e nxjerra nga Dega Doganore.

Rekomandimi B4 Të arkëtohet vlera prej 6,668,995 lekë, nga subjektet, sipas trajtimit në faqet 198-207 të RPA, për mos llogaritje dhe mos arkëtim të detyrimeve doganore dhe penalteteve sipas KD, për pranim të vlerës së transaksionit jo në përputhje me kërkesat dhe kriteret ligjore, paraqitur në aneksin nr. 3, të pa përfshira në vendimet e nxjerra nga Dega Doganore.

Rekomandimi B5 Të arkëtohet vlera prej 4,544,047 lekë, nga subjektet, sipas trajtimit në faqet 207-211 të RPA, për mos llogaritje dhe mos arkëtim të detyrimeve doganore dhe penaliteteve sipas KD, për pranim të vlerës së transaksionit jo në përputhje me kërkesat dhe kriteret ligjore, paraqitur në aneksin nr. 3, të pa përfshira në vendimet e nxjerra nga Dega Doganore.

Rekomandimi B6 Të arkëtohet vlera prej 47,423,809 lekë nga 2 subjekte, sipas trajtimit në faqet 218-230 të RPA, për mos llogaritje dhe mos arkëtim të detyrimeve doganore si difference e dalë nga inventarët fizik në zbatim të KD dhe të udhëzimit nr. 1, datë 14.07.2009, të pa përfshira në vendimet e nxjerra nga Dega Doganore.

Nga **Dega e Doganës Tiranë**, rikërkohet zbatimi i rekomandimeve të KLSH, të dërguar me shkresën nr. 11/6, datë 30.06.2014, të cilat nga auditimi i kryer kanë rezultuar të pa zbatuara, sa më poshtë:

Rekomandimi B1 Të arkëtohet vlera prej 9,285,762 lekë, sipas trajtimit në faqet 22-122 të raportit për mos llogaritje dhe mos arkëtim të detyrimeve doganore dhe penalitete sipas KD, për pranim të vlerës së transaksionit jo në përputhje me kërkesat dhe kriteret ligjore, për vitin 2013 sipas aneksit nr. 4, bashkëlidhur raportit.

Rekomandimi B2 Të arkëtohet vlera prej 1,916,421 lekë, sipas trajtimit në faqet 22-122 të raportit për mos llogaritje dhe mos arkëtim të detyrimeve doganore dhe penalitete sipas KD, për pranim të vlerës së transaksionit jo në përputhje me kërkesat dhe kriteret ligjore, për vitin 2012 sipas aneksit nr. 5, bashkëlidhur raportit.

Rekomandimi B3 Të arkëtohet vlera prej 7,766,205 lekë, nga subjekti [REDAKTUAR] sipas trajtimit në faqet 87-98 të raportit për mos llogaritje dhe mos arkëtim të detyrimeve doganore dhe penalitete sipas KD, për pranim të vlerës së transaksionit jo në përputhje me kërkesat dhe kriteret ligjore, në 17 deklarata doganore për vitin 2012 dhe në 8 deklarata doganore për vitin 2013, për artikullin banane, sipas aneksit nr. 6, bashkëlidhur raportit, të pa përfshira në vendimet e nxjerra nga Dega Doganore.

Rekomandimi B4 Të arkëtohet vlera prej 1,797,680 lekë, nga 13 subjekte sipas trajtimit në faqet 22-122 të raportit për mos llogaritje dhe mos arkëtim të detyrimeve doganore dhe penalitete sipas KD, për klasifikim të artikujve jo në përputhje me nomenklaturën e mallrave, në 3 deklarata doganore, për vitin 2012 dhe në 19 deklarata doganore për vitin 2013, që DD Tiranë nuk i ka përfshirë në vendimet e marra.

Rekomandimi B5 Të arkëtohet vlera prej 2,401,592 lekë, nga 8 subjekte sipas trajtimit në faqet 118-123 të raportit për mos llogaritje dhe mos arkëtim të detyrimeve doganore dhe penalitete sipas KD, për përcaktimin e origjinës së mallrave jo në përputhje me dokumentet shoqëruese sipas kërkesave dhe kriterëve ligjore, në 10 deklarata doganore, për periudhën 2012-2013, sipas aneksit nr. 8, bashkëlidhur raportit, të pa përfshira në vendimet e nxjerra nga Dega Doganore.

Rekomandimi B6 Të arkëtohet vlera prej 1,999,240 lekë, nga 25 subjekte sipas trajtimit në faqet 130-150 të raportit për penalitete mbi kundërvajtjet administrative të evidentuara në procesin e mbikëqyrjes së regjimeve të përpunimit aktiv e pasiv të mallrave sipas KD, në 24 autorizime të audituara për periudhën 2011-2013 sipas aneksit nr. 9, bashkëlidhur raportit, që Dega Doganore nuk i ka përfshirë në vendimet e marra.

Rekomandimi B7 Të arkëtohet vlera prej 9,590,072 lekë, nga 3 subjekte sipas trajtimit në faqet 152-162 të raportit për mos marrje vendim për detyrimin e papaguar në afat si dhe për mos llogaritje interesa për çdo ditë vonesë të pagesës së tvsh së shtyrë, në kundërshtim me VKM nr. 599, datë 16.08.2006 “Për skemën e shtyrjes së tvsh-së për makineritë e pajisje të importuara, si dhe energjinë elektrike të importuar nga KESH” i ndryshuar me VKM nr. 1674, datë 24.12.2008,

UMF nr. 1, datë 26.09.2006 “Për zbatimin e skemës së shtyrjes së pagesës së tvsh” që përcakton VKM nr. 599, datë 16.08.2006” për periudhën 2011-2013 sipas aneksis nr. 10, bashkëlidhur raportit, që Dega Doganore nuk i ka përfshirë në vendimet e marra.

Rekomandimi B8 Të arkëtohet vlera prej 650,000 lekë, nga subjekti [REDAKTUAR], sipas trajtimit në faqet 127-129 të raportit për penalitete mbi kundërvajtjet administrative të evidentuar në magazinën e lirë doganore për mosrespektimin e afatit të qëndrimit në magazinë dhe për mos mbyllje të regjimit doganor për 7 raste, jo në përputhje me kërkesat e nenit 256/1/256/4, 272/2, 275/2 dhe 287/2/F të KD, për periudhën 2012-2013, që Dega Doganore nuk i ka përfshirë në vendimet e marra.

Nga **Dega e Doganës Kakavijë**, rikërkohet zbatimi i rekomandimeve të KLSH, të dërguar me shkresën nr. 578/17, datë 19.09.2014, të cilat nga auditimi i kryer kanë rezultuar të pa zbatuara, sa më poshtë:

Rekomandimi B1 Nga Dega e Doganës Kakavijë, të kryhet kontabilizimi dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit në vlerë 5,035,100 lekë, që nuk janë përfshirë në vendimet e marra.

Rekomandimi B2 Nga Dega e Doganës Kakavijë, të kryhet kontabilizimi dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit në vlerë 21,375,540 lekë, që nuk janë përfshirë në vendimet e marra.

Nga **Dega e Doganës Kapshticë**, rikërkohet zbatimi i rekomandimeve të KLSH, të dërguar me shkresën nr. 322/8, datë 30.06.2014, të cilat nga auditimi i kryer kanë rezultuar të pa zbatuara, sa më poshtë:

Rekomandimi B1 Për tre subjekte [REDAKTUAR] në vlerën 18,001,815 lekë, sipas anekseve 1, 1/1, dhe 1/2 bashkangjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit, të vazhdojnë procedurat pas marrjes së përgjigjeve të kërkesave për investigim drejtuar Doganës Greke, nga Departamenti Operativ Hetimor në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, sipas kërkesës së bërë nga Dega e Doganës Kapshticë, pa përfshirë në vendimet e nxjerra nga DD.

Rekomandimi B6 Vlera prej 550,000 lekë, nga subjekti [REDAKTUAR] sipas aneksi 6, trajtuar në faqet nr. 212-226 të RPA, gjoba të rekomanduara për mungesë të kartave teknologjike për përcaktimin e koeficientit të shfrytëzimit për artikujt e prodhuar, për diferenca të bilancit import-eksport, veprime në kundërshtim me nenin 140 të ligjit nr. 8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i RSH-së”, VKM nr. 205, datë 13.04.1999 “Për dispozitat zbatuese të KD-së” si dhe udhëzimit nr. 1, datë 06.09.2012 “Për zbatimin praktik të regjimit të përpunimit aktiv”, të pa përfshira në vendimet e nxjerra nga DD.

Nga **Dega e Doganës Bllatë**, rikërkohet zbatimi i rekomandimeve të KLSH, të dërguar me shkresën nr. 434/7, datë 07.08.2014, të cilat nga auditimi i kryer kanë rezultuar të pa zbatuara, sa më poshtë:

Rekomandimi B4 Kërkohet të arkëtohet vlera prej 1,044,352 lekë nga subjektet: [REDAKTUAR] për shumën 389,574 lekë si dhe [REDAKTUAR] në shumën 654,778 lekë, sipas trajtimit në faqet 70-71 të Raportit Përfundimtar për shkelje të procedurave të vlerësimit të taksës së rentës minerare, në kundërshtim me ligjin nr. 10304, datë 15.07.2010 “Për sektorin minerar në RSH”, neni 40, ligjin nr. 10280, datë 20.05.2010 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9975, datë 28.07.2008

“Për taksat kombëtare” të ndryshuar, dhe ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH”, neni 117, që nuk janë përfshirë në vendimet e marra.

Rekomandimi B6 Kërkohet të arkëtohet vlera prej 385,492 lekë nga subjekti [REDAKTUAR] për shumën 189,174 lekë artikulli “pëlhurë sintetike” dhe subjekti [REDAKTUAR], në shumën 196,318 lekë, për mos llogaritje dhe mos arkëtim të detyrimeve doganore për artikullin “pëlhurë sintetike” dhe “mallra të përdorura”, trajtuar hollësisht në faqet 59-60, të Raportit Përfundimtar, në kundërshtim me ligjin nr. 8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i RSH” me ndryshimet nenet 34-40 të tij, që nuk janë përfshirë në vendimet e marra.

Rekomandimi B8 Kërkohet të arkëtohet vlera prej 175,326 lekë, nga subjekti [REDAKTUAR] sipas trajtimit në faqet 56-57, të raportit për mos llogaritje dhe mos arkëtim të detyrimeve doganore sipas KD, për pranim të vlerës së transaksionit në artikullin “krunde gruri”, jo në përputhje me kërkesat dhe kriteret ligjore, në 6 deklarata doganore viti 2012 dhe në 11 deklarata doganore për vitin 2013, për artikullin “krunde gruri”, që nuk janë përfshirë në vendimet e marra.

Rekomandimi B9 Kërkohet të arkëtohet vlera prej 61,678 lekë, nga subjekti [REDAKTUAR], sipas trajtimit në faqet 49-50 raportit për mos llogaritje dhe mos arkëtim të detyrimeve doganore sipas KD, për pranim të vlerës së transaksionit në artikullin “Sfungjer për divan”, jo në përputhje me kërkesat dhe kriteret ligjore në 3 deklarata doganore, për vitin 2011 dhe 1(një) deklaratë për vitin 2013, që Dega e Doganës Bllatë nuk i ka përfshirë në vendimet e marra.

Nga **Dega e Doganës Fier**, rikërkohet zbatimi i rekomandimeve të KLSH, të dërguar me shkresën nr. 13/6, datë 31.03.2014, të cilat nga auditimi i kryer kanë rezultuar të pa zbatuara, sa më poshtë:

Rekomandimi B1 Nga Dega e Doganës Fier të kryhet kontabilizimi dhe të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit në vlerën prej 1,749,236 lekë, nga 10 punonjës të klasifikuar si më poshtë:

- nga 7 persona sipas aneksit nr. 4 të Raportit Përfundimtar të Auditimit,
- nga 2 persona sipas aneksit nr. 5 të Raportit Përfundimtar të Auditimit,
- nga 2 persona sipas aneksit nr. 6 të Raportit Përfundimtar të Auditimit,
- nga 2 persona sipas aneksit nr. 7 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Rekomandim B2.2 Kërkohet të arkëtohet vlera prej 1,174,813 lekë për 4 raste në dy subjektet [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR], të trajtuara hollësisht në faqet 10-28 dhe 30-80 të Raportit Përfundimtar të Auditimit si rezultat i veprimeve jo në përputhje me kërkesat e neneve 34-39; 256.4; 261.1; 261.2 dhe 261.3 të Kodit Doganor; i veprimeve jo në përputhje me përcaktimet e kërkesave të Sesionit I të Udhëzimit 25, datë 30.11.2007 të MF “Për procedurat e shqyrtimit të vlerës doganore...” si dhe veprimeve jo në përputhje me përcaktimet e kërkesave të “Protokollit të Origjinës” gjatë procedurave të zhdoganimit të mallrave, që Dega e Doganës Fier nuk i ka përfshirë në vendimet e marra.

Rekomandim B2.4 Kërkohet të arkëtohet vlera prej 1,106,294 lekë nga 4 subjekte sipas aneksit 8 të Raportit të trajtuar hollësisht në faqet 113-115 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, si rezultat i veprimeve jo në përputhje me kërkesat e neneve 287.1 dhe 289.1 të Kodit Doganor gjatë procedurave të vendimmarrjes, që Dega e Doganës Fier nuk i ka përfshirë në vendimet e marra.

C. MASA DISIPLINORE

Nga **Dega e Doganës Kapshticë**, rikërkohet zbatimi i rekomandimeve të KLSH, të dërguar me shkresën nr. 322/8, datë 30.06.2014, të cilat nga auditimi i kryer kanë rezultuar të pa zbatuara, sa më poshtë:

Rekomandimi C1 Mbështetur në nenin 59, të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil” dhe VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, i kërkojmë Drejtores së Përgjithshme të Doganave dhe Kryetarit të Degës Doganës Kapshticë, që në vlerësim të shkeljeve të konsideruar nga ana jonë si shkelje të rënda dhe shumë të rënda të bëjë klasifikimin e tyre dhe të urdhërojë fillimin e procedurave përkatëse për dhënien e masave disiplinore sipas VKM nr. 115, datë 05.03.2014 dhe ligjit nr. 152/2013, *për 4 nëpunës civil të Degës së Doganës Kapshticë*.

Nga **Dega e Doganës Bllatë**, rikërkohet zbatimi i rekomandimeve të KLSH, të dërguar me shkresën nr. 434/7, datë 07.08.2014, të cilat nga auditimi i kryer kanë rezultuar të pa zbatuara, sa më poshtë:

Rekomandimet C.3/4/5 Mbështetur në nenin 59, pika 1 dhe 4, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” dhe VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, Kreu II, pika 3, 6, 9, 10 dhe 11 i kërkojmë Drejtores së Përgjithshme të Doganave dhe Kryetarit të Degës Doganës Bllatë që në vlerësim të shkeljeve të konsideruara nga ana jonë si shkelje të rënda dhe shumë të rënda të bëj klasifikimin e tyre dhe të urdhërojë fillimin e procedurave përkatëse për dhënien e masave përkatëse disiplinore sipas VKM nr. 115, datë 05.03.2014 dhe ligjit nr. 152/2013, *për 3 nëpunës civil të Degës Doganës, Bllatë*.

D. MASA ADMINISTRATIVE

Nga **Dega e Doganës Tiranë**, rikërkohet zbatimi i rekomandimeve të KLSH, të dërguar me shkresën nr. 11/6, datë 30.06.2014, të cilat nga auditimi i kryer kanë rezultuar të pa zbatuara, sa më poshtë:

Mbështetur në nenin 275.1 dhe 287.2/f të ligjit nr. 8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i RSH” t’i kërkojmë Kryetarit të Degës Doganës, Tiranë të fillojë procedura për të vendosur gjobë në masën nga 50,000 deri në 200,000 mijë lekë *për 5 agjenci doganore të rekomanduara*.

Nga **Dega e Doganës Kakavijë**, rikërkohet zbatimi i rekomandimeve të KLSH, të dërguar me shkresën nr. 578/17, datë 19.09.2014, të cilat nga auditimi i kryer kanë rezultuar të pa zbatuara, sa më poshtë:

Mbështetur në nenin 275.1 dhe 287.2/f të ligjit nr. 8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” t’i kërkojmë Kryetarit të Degës Doganës, Kakavijë të fillojë procedura për të vendosur gjobë në masën nga 50,000 deri në 200,000 mijë lekë *për 2 agjenci doganore të rekomanduara*.

E. PËR DEGËN E DOGANËS VLORË

Në përfundim të auditimit “Mbi verifikimin e zbatimit të masave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm”, në zbatim të Programit të Auditimit nr. 1130/6, datë 04.12.2014 të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, ka rezultuar se nga Dega e Doganës Vlorë, nuk është

zbatuar asnjë prej rekomandimeve të lëna nga Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr. 222/19, datë 30.06.2014, si dhe nuk i është kthyer përgjigje Kontrollit të Lartë të Shtetit brenda afatit 20 ditë, përcaktuar në ligjin nr. 8270, datë 23.12.1997 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”, ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 01.06.2000, neni 16, veprim për të cilin nga Grupi i auditimit është mbajtur Procesverbali nr. 1, datë 18.12.2014.

Nga **Dega e Doganës Vlorë**, rikërkohet zbatimi i rekomandimeve të KLSH, të dërguar me shkresën nr. 222/19, datë 30.06.2014 “Raporti Përfundimtar i Auditimit dhe rekomandimet”, të cilat nga auditimi i kryer kanë rezultuar të pa zbatuara.

Shënim: Auditimet u kryen përgjatë muajit dhjetor 2014 - janar 2015, nga audituesit Brunilda Zeneli, Albert Thoma, Agron Opari, Edvin Stefani, Anesti Gjika, Livan Hoxha, Hekuran Avdulaj, Vladimir Rizvani, Bashkim Shehu, Joniada Gocaj, Marvin Karalli dhe Xhovan Domi, u mbikëqyrën nga Kryeaudituesi z. Albert Thoma, më tej u shqyrtuan nga Drejtori i Departamentit zj. Albana Agolli dhe Drejtori i Drejtorisë Juridike, Sigurimit të Cilësisë dhe Analizës së Riskut z. Ermal Yzeiraj.

Mbi zbatimin e rekomandimeve:

Nga subjektet që është rikërkuar zbatimi i rekomandimeve të pazbatuara kanë kthyer përgjigje për masat e marra për zbatimin e rekomandimeve, Dega e Doganës Kapshticë, me shkresë nr. 1130/41, datë 16.03.2015, Dega e Doganës Kakavijë, me shkresë 1130/42, datë 03.04.2015, Dega e Doganës Fier, me shkresë nr.1130/43, datë 09.04.2015 dhe Dega e Doganës Durrës me shkresë nr.1130/46, datë 28.05.2015.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT